

**VENDIM**  
**Nr.29, datë 20.1.2010**

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QENDROR TË PËRHERSHËM, PËR KTHIMIN NË  
ATDHE TË ESHTRAVE TË PERSONALITETEVE TË SHQUARA SHQIPTARE<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.360, datë 20.6.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e Komisionit Qendror të Përhershëm, për përjetësimin e veprës dhe të kontributit në dobi të atdheut të personaliteteve dhe të figurave të shquara kombëtare.
  2. Komisioni të kryesohet nga ministri i Kulturës dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:  
*Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;*  
*Këshilltarin e Kryeministrit;*  
*Drejtorin e Protokollit të Shtetit në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.*
  - 2.1 Në mbledhjet e komisionit, për çdo rast të marrë në shqyrtim, ftohen të marrin pjesë:
    - Kryetari i bashkisë së territorit ku do të prehen eshtrat e personalitetit;
    - Përfaqësuesi i subjektit publik/organizatës shoqërore që ka iniciuar kërkesën e kthimit në atdhe të eshtrave të personalitetit;
    - Përfaqësuesi i familjes së personalitetit;
    - Përfaqësues nga Akademia e Shkencave, historian ose personalitet tjetër, njohës i veprimtarisë së personalitetit.
  3. Komisioni, nëpërmjet *Ministrit të Kulturës*, propozon për miratim projektaktet përkatëse, në Këshillin e Ministrave, për kthimin në atdhe të eshtrave dhe organizimin e ceremonisë zyrtare për personalitetet dhe figurat e shquara kombëtare, për çdo rast.
  4. Efektet financiare që rrjedhin, sipas rastit, të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë, fushës së të cilës i përket personaliteti.
  5. Ngarkohen *Ministria e Kulturës*, Komisioni Qendror i Përhershëm dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

---

<sup>1</sup> VKM nr. 29, datë 20.1.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 10 shkurt 2010.  
VKM nr. 360, datë 20.6.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.94, datë 25 qershor 2018.